

Sinjalizime

Ndërhyri vajza për ta ndarë konfliktin mes prindërve, përfundon e lënduar bashkë me nënën – Policia sekuestron edhe një “TT”



Sinjali.com

20 Gusht 2026 09:29



Një konflikt brenda një familjeje ka përfunduar me nënë e bijë të lënduara, një armë të sekuestruar dhe arrestimin e kryefamiljarit mbrëmjen e së mërkurës në Ferizaj, mëson Sinjali.

Rasti ka ndodhur më 19 gusht, rreth orës 21:00, ndërsa informacioni fillestar për një rast të dyshuar të dhunës në familje është pranuar nga Policia rreth orës 21:30.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, në rast janë përfshirë A.I. rreth 55-vjeç, bashkëshortja e tij L. I. rreth 49-vjeç dhe vajza e tyre E. I. rreth 28-vjeç.

Bazuar në deklarin e L. I. para hetuesve, pas një mosmarrëveshjeje me bashkëshortin, situata dyshohet se ka eskaluar në dhunë fizike. Ajo ka deklaruar se bashkëshorti e kishte kapur për fyti dhe për duar, duke i shkaktuar lëndime.

Në konflikt më pas ka ndërhyrë vajza e çiftit.

E. I. ka deklaruar se kishte tentuar t'i ndante prindërit, me qëllim që situata të mos përshkallëzohej më tej. Pikërisht gjatë ndërhyrjes së saj, sipas deklarimeve të viktimave, babai dyshohet se i ka shtyrë të dyja, duke i rrëzuar në tokë.

Si pasojë, si nëna ashtu edhe vajza kanë pësuar lëndime trupore.

Por gjatë intervenimit policor është zbuluar edhe një element tjetër i rastit.

Kur është pyetur nëse posedonte armë në shtëpi, A. I. ka deklaruar vullnetarisht se posedonte një të tillë dhe ua ka prezantuar zyrtarëve policorë.

Arma është sekuestruar dhe rezulton të jetë pistoletë TT M57, së bashku me një karikator dhe tre fishekë të kalibrit 7.62 mm.

Fillimisht në vendngjarje kishin dalë njësitet policore nga Vitia, ndërsa pasi është konstatuar se rasti i takonte territorialisht Ferizajt, procedurat e mëtejshme janë marrë nga njësitet kompetente të këtij stacioni.

Pas intervistimit të palëve dhe konsultimit me Prokurorin e Shtetit, ndaj A.I. janë iniciuar rastet për “Lëndim të lehtë trupor” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Me vendim të Prokurorit, 54-vjeçari është ndaluar për 48 orë.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Policia

Ferizaj

vajza


Armë

Dhunë

babai

Nëna

Të tjera:



Ekskluzive | I kërkuar nga drejtësia, bie në pranga i dënuari me 1 vit e 215 ditë burg – Polici...

Sinjalizime



72 armë, granata e uniforma serbe – Hoxha tregon çfarë gjeti Policia në Zubin-Potok

Siguri



Ekskluzive | Ky është 27-vjeçari i arrestuar në Brezovicë – mbi 1 kilogram marihuanë u...

Sinjalizime



Ekskluzive | Tentoi t'i ikte Policisë duke kërcyer nga ballkoni – 32-vjeçari thyen të dyj...

Sinjalizime



Ekskluzive | Alarm për armë në “Eclipse” në Ferizaj, Policia zbarkon në lokal – arrestohet...

Sinjalizime




Ekskluzive | Shkon vetë në Polici për t'i raportuar armët me leje të skaduara – 39-vjeçarit...

Sinjalizime



Ekskluzive | Hajni tenton t'ia mbathë nga kati i tretë, policët i shkojnë pas nëpër ballkone – 3...

Sinjalizime



Gjendet 15-vjeçarja nga Peja që ishte raportuar e zhdukur – Policia e lokalizon pas kërkimev...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera

